SHTETI UTHMAN DHE PIKPAMJA E DAVETIT TË SHEJH MUHAMMED IBN ABDULVAHAB LIDHUR ME ATË



SHEJH NASR IBN HAMED EL-FEHD - ALLAHU E LIROFTË



Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.

Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut, paqja dhe lutjet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut ﷺ, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndoqën atë.

Të fillojmë:

Ky është një studim i shkurtër që e sqaron realitetin e shtetit Uthman, të cilët shumë nga ata që quhen "mendimtarë Islam", e lavdërojnë dhe flasin mirë për të dhe e përshkruajnë atë si një nga bastionët (fortesat) e fundit të Islamit, shkatërrimi i së cilës e hoqi nderin e Muslimanëve.

Gjithashtu, ky (studim) e sqaron realitetin e pozitës së davetit të Shejh Muhamed ibn 'Abdul-Vahabit - Rahimehullahu Te'aalaa - në lidhje me këtë shtet.

Dhe unë e kam ndarë këtë në dy sektore:

Sektori i parë: Në lidhje me shtetin Uthman.

Sektori i i dytë: Në lidhje me pikëpamjen e Da'vetit të Shejhut lidhur me atë.

SEKTORI I PARË:

REALITETI I SHTETIT UTHMAN

Me të vërtetë, kushdo që e konsideron natyrën e shtetit Uthman - që nga ngritja e saj deri në rënien e saj - nuk do të ketë asnjë dyshim në lidhje me kontributin e saj të drejtpërdrejtë në korruptimin e Akidës (besimit) të Muslimanëve dhe kjo bëhet e qartë përmes dy çështjeve :

E para: Përmes përhapjes së Shirkut.

E dyta: Përmes luftës të saj kundër Teuhidit.

[Ata të cilët e mbrojnë luftën e 'Uthmanlive kundër ed-Da'vës es-Selefijeh pohojnë se kjo luftë ishte një luftë politike. Por rasti nuk është kështu; përkundrazi që nga fillimi ishte një luftë e bazuar në Akide, e nisur nga fetavaat e 'Ulemaave të tyre nga kuburijuunët (adhuresit e varreve).

[Shih Haashijat Ibn 'Aabidiin, 4/262.]

Dhe shteti Uthman e përhapi shirkun duke e përhapur -*shirkun e bazuar*- ***Tasavvuf*** që është i bazuar në adhurimin e varrëve dhe evlijave, dhe ky është një fakt i vërtetuar që askush nuk argumenton reth asaj, madje as ata që e mbrojnë atë. Dhe unë do ti citoj në atë çka pasohet nga disa nga tekstet që vërtetojnë këtë, nga simpatizuesit e vet shtetit Uthman:

Abd el-'Aziz esh-Shenaavi ka thënë në librin e tij ed-Deule el-'Uthmaanijjeh: Deule Islaamijjah Mufteraa 'Alejhaa (Shteti Uthman : Një shtet i shpifur Islam)   (1/59) - nga mënyra e lavdërimit -:

"Dhe një nga manifestimet e drejtimit fetar në politikën e shtetit ishte inkurajimi i - ***Tasavvuf*** - në mesin e Uthmanlive dhe shteti u dha meshejkhëve (hoxhallarëve) të tarikatëve të Sufi've radhitje të gjërë të autoritetit dhe fuqisë mbi studentët dhe pasuesit e tyre. Dhe këto tarikate fillimisht u përhapën në Azinë Qendrore, pastaj ato u zhvendosën në shumicën e zonave të shtetit ... Dhe shteti ua zgjati dorën e ndihmës financiare disave prej tariaktëve Sufi ... Dhe disa nga tarikatët më të rëndësishme Sufi ishin Nakshebanditë, Mevlavijjah'ët, Bektashitë dhe Rifaa'ijjët ... " [Mbaron citati.]

[Dhe këto tarikate janë të gjitha të bazuara në adhurimin e varreve dhe evlijave, dhe në të vërtetë mbi Shirkun Rububijjah që mushrikët Arab kishin besim të përhershëm, dhe kjo është nëpërmjet besimeve të Sufi've në "el-ghavth", "el-aktaab" , "el-abdaal", dhe të tjerët të cilët pretenduan që e kontrollojnë universin (gjithësin). Referojuni asaj që Shejh el-Islam [Ibn Tejmijje] ka shkruar rreth Sufi've dhe debatet e tij me pasuesit e Rifaa'ijjëve (el-Fetavaa, vëllimi 11) dhe i referojuni asaj që Ihsaan Ilaahi Dhahiir ka shkruar rreth Sufi've dhe rreth këtyre tarikatëve dhe zakonëve të tyre të shirkut në librin e tij - ***Diraasaat fit-Tasavvuf*** - (Studimet lidhur me Tasavvuf'in), dhe çfarë es-Sindi shkroi në librin e tij ***- Et-Tasavvuf fih Miizaan el-Bahth vet-Tahkiik*** - (Tasavvuf në peshorën e hetimit dhe verifikimit), dhe çfarë al-Vekiil shkroi në librin e tij - ***Hedhihi Hija es-Sufijjah***- (Ky është Sufizmi). Dhe një përshkrim i detajuar i disa prej këtyre tarikatëve do të ndjekën, insha'Allah.]

Dhe Muhammed Kutbi tha në librin e tij - ***Veeki'unaa el-Mu'aasir***- (gjendja jonë e tanishme), faqja 155:

"Sufizmi filloi të përhapet në shoqërinë Abasite, por ishte një kënd i izoluar i shoqërisë. Por, ndër hijen e shtetit Uthman dhe për të qenë më i saktë në Turqi, ajo u bë vetë shoqëria dhe u bë vetë feja ." [Mbaron citati.]

El-Mevsuu'ah el-Mujesserah fil-Adjaan vel-Medhaahib el-Mu'aasirah (Përmbledhja e Thjeshtë e Feve dhe Sekteve Bashkëkohore), faqe 348:

"El-Bektaashijjah (Bektashitë): Uthmanët Turq ishin të lidhur me këtë tarikat dhe kjo vazhdon të jetë e përhapur në Shqipëri dhe është më afër tasavvuf'it shiitë se sa tasavvuf'it sunni ... dhe ajo kishte autoritet të madh mbi sunduesit e vetë 'Uthmanlive". [Mbaron citati.]

[Të gjitha llojët e tasavvuf janë ndryshim dhe bidat, dhe nuk ka gjë të tillë si një "tasavvuf sunni". Dhe do të ketë vazhdimësi tek detajet e këtij tarikati të veçantë.]

Dhe në librin - ***el-Fikr es-Sufi fih Dhev el-Kitaab ve-Sunnah*** - (Të menduarit Sufi në Dritën e Librit dhe Sunetit), faqe 411:

"Dhe sulltanët e Uthmanlive garuan me njëri-tjetrin në ndërtimin e teqëve, zaavijjëve dhe varreve të Bektashive. Kështu që disa nga sultanët e mbështetën atë dhe disa të tjerë ishin kundërshtarë të tyre, duke preferuar një Tarikat tjetër të ndryshëm". [Mbaron citati.]

Për këtë arsye, nuk është për t'u habitur që shirku dhe kufri u përhapën dhe Teuhidi filloi të zhduket, në vendet ku ata sundonin. Dhe Shejh Husejn ibn Ghannaam - rahimehullaahu te'ala - ka thënë, duke i përshkruar vendet e tyre:

"Shumica e njerëzve në kohën e tij - (dmth Shejh Muhamed ibn 'AbdulVahabit) - ishin zhytur në ndotje dhe ishin njollosur nga balta e papastërtisë deri në masën që ata shkuan me vrull tek shirku, pasi që Suneti ishte varrosur ...

Kështu që ata u kthyen në adhurimin e evlijave dhe njerëzve të drejtë, dhe ata e hodhën poshtë jakën e Teuhidit dhe të Fesë. Kështu që ata u përpoqën të kërkonin ndihmë prej tyre në kohë fatkeqësirash, aksidentesh dhe ngjarjëve shkatërruese, dhe vrapuan tek ata duke i kërkuar që ti përmbushin nevojat e tyre dhe ti largonin vështirësitë e tyre, nga të gjallët në mesin e tyre, si dhe nga të vdekurit e tyre. Dhe shumë njerëz besonin që sendet e pajetë mund ti sjellnin ndihmë apo dëm ... "Pastaj përmendi format e shirkut që ekzistonin në Nexhd, Hixhazë, Irak,Shamë, Egjipt dhe tjetërkund [Mbaron citati]

[Revdhat el-Afkar, faqe 5 , më tutje.]

Imam Sa'ud ibn 'Abdul-Aziz - Rahimehullaahu Te'ala - (vdiq 1229H) ka thënë:

Në një nga letrat e tij drejtuar' guvernatorit Uthman të Irakut, duke e përshkruar natyrën e shtetit të tyre:

"Kështu që she'aa'iri (simbolet) e kufrit në Allahun dhe shirku, kjo është situata që ekziston mes jush. Të tilla si ndërtimi i kupave mbi varre, ndriçimi i llambave mbi ta, varja e perdeve mbi ta, vizitat tek ata në mënyra të pa ligjshme nga Allahu ose i Dërguari i Tij, festimet e festave vjetore atje dhe të kërkuarit ndaj tyre të varrosurëve aty për ti përmbushur nevojat, për ti hequr vështirësitë dhe për t'iu përgjigjur lutjeve; e gjithë kjo bashkë me braktisjen e obligimeve të detyrueshme të fesë që Allahu ka urdhëruar të vendosen, të tilla si pesë namazët dhe të tjera prej tyre. Për atë që dëshiron të falët, falët i vetëm, dhe ai që lë namazin nuk kundërshtohet. Po kështu është rasti me zekatin. Dhe kjo çështje është përhapur dhe është bërë e njohur, dhe ka mbushur veshët e shumë vetëve tek tokat e Shamit,Irakut, Egjiptit dhe vendeve të tjera nga shtetët. " [Mbaron citati.]

[Ed-Durar Es-Senijjeh, 1/382.]

Kjo ishte, shumë shkurtimisht, gjendja e shtetit Uthman. Nëse citatet e mësipërme nuk janë të mjaftueshme për ta bindur një person për këtë, atëherë nuk ka shpresë për atë që të kuptojë.

Dhe sa i përket situatës së sulltanëve të tyre - të cilën tashmë e kam treguar shkurtimisht - është gjithashtu i këtij lloji. Dhe unë do ti përmendi disa shembuj të llojllojshëm të këtyre sulltanëve, në mënyr që ta qartësoj gjendjen e tyre:

Sulltan Orhan i Pari (vdiq 761H):

Ai është sulltani i dytë i këtij shteti, pasi babai i tij Uthmani ('Uthmani i pari vdiq 726H).

Sundimi i tij zgjati 35 vjet. Dhe ky sultan ishte një sufi mbi tarikatin Bektashi.

[Shih Tarikh ed-Deule el-'Alijjah el-'Uthmaanijjah, faqe 123, dhe el-Fikr es-Sufi, faqe 411. Dhe el-Bektaashijjah është shkruar gjithashtu el-BekDaashijjah (me një "deel" د) dhe el- BakTashiyyah (me një "taa" "ط). Dhe historianët kanë përmendur për këtë sultan që e ndihmoi mbretin Romakë kundër mbretit Serb, sepse mbreti Romak i premtoi t'i jepte atij bijën e tij për martesë. Shih Taarikh ed-Deule, faqe 125.]

Dhe tarikati Bektaashi të cilën e kam përmendur disa herë, është sufi, shi'itë, tarikat baatini i themeluar nga Khankaar Muhammed Bektaash el-Khurasaani, i cili e përhapi atë në Turqi në vitin 761H. Dhe kjo është një përzierje e akides së Vehdat el-Vuxhud'it *(uniteti i të gjithë ekzistencës, në thelb duke mohuar ndarjen e Allahut nga krijimi i Tij*), adhurimi dhe hyjnzimit të meshejkh'ëve (hoxhallarëve), akideja e Rafidive në lidhje me imamët dhe ekzagjerimit në lidhje me Profetin ﷺ në një mënyrë që i nxjerr ata nga Islami.

Dhe nga kjo është thënia e nxënësit ose "muriid'it" kur ai dëshiron të hyjë në këtë tarikat: "Unë kam ardhur me dëshirë të zjarrtë në derën e së vërtetës si një lypës, duke pohuar Muhammedin dhe Hajdarin (dmth. Aliun) dhe duke kërkuar (es-sirr) dhe nga derdhja (el-fejdh) nga të dyja, dhe nga ez-Zahraa '(dmth Fatimën) dhe Shubejr dhe Shabar (dmth. Husejni dhe Hasani). " Pastaj ai thotë:

"Dhe me dashuri e kam dorëzuar veten time të brendshëm si një shërbëtor i familjes së Abbas'it dhe strehimi im është el-Haxh Bektaash, Kutbi (boshti) i evlijave." Dhe ai i thotë shejhut: "Fytyra yte është një llambë dhe një fener i udhëzimit, fytyra yte është një tregues i formës të së vërtetës, fytyra yte është Haxh, Umre dhe Zijaara, fytyra yte është tek ata të bindurit në kiblën e udhëheqjes, fytyra yte është një përmbledhje e Kuranit. "

Dhe evraadi i Baktaashive janë mbi Akiden e " Ithna' Esharijjah Raafidah" . Dhe ata kanë nga akid'eja e tyre, nga evraadi i baatini'ëve dhe mënyra e vizitës tek varret për të marrë "pranimin" e të - bazuarit në shirk- , gjëra të tilla që janë shumë të tmerrshme për t'u përmendur.

[Shih ato në hollësi tek el-Fikr es-Sufi fi dhev el-Kitaab ve Sunnah, Faqe 409-424]

Sulltan Muhammed i Dyti (El-Fatih, vdiq 886H):

Ai është njëri nga më të famëshmit e sulltanëve të këtij shteti, dhe ai ka sunduar për 31 vite.

Pas çlirimit të Konstandinopojës (Stambollit) në vitin 857H, ai e zbuloi vendin e varrit të Ebu Ejub el-Ensariut - RadiAllahu anhu dhe e ndërtoi një varr mbi të, dhe pranë tij ndërtoi një xhami, dhe xhamia u dekorua me guri të bardhë . Dhe ai ndërtoi mbi varrin e Ebu Ejubit një kupë. Dhe zakonet e Uthmanlive, në ndjekjen e tyre të sulltanëve ishin se ata vinin në një procesion të madh tek kjo xhami, pastaj sulltani i ri hynte në këtë varr dhe merrte shpatën e sulltanit 'Uthman i pari' nga shejhu i tarikatëve Mevlavi.

[Shih ed-Deule el-Uthmanijjah: Deule Islamijjah Muftera Alejhaa, 1/64]

Dhe ky sulltan ishte i pari që i përcaktoi themelet e "ligjit civil" dhe "ligjit penal". Pra, ai zëvendësoi dënimet fizike sheriatike që janë transmetuar nga Libri (Kur'ani) dhe Sunneti - dmth një dhëmb për një dhëmb dhe një sy për një sy - me gjoba monetare (të holla), në një metodologji të qartë që u përfundua nga Sulltaan Sulejman el-Kanuni .

[Shih Tariikh ed-Deule el-Alijjah faqe 177 dhe Fet'h el- Kostantiinijjah ve Muhammed el Fatih, faqe 177]

Dhe ai gjithashtu lëshoi një legjislacion - që vazhdoi të zbatohej pas tij - që ishte se çdo sulltan i cili erdhi në pushtet mund ti vriste të gjithë vëllezërit e tij, kështu që froni të jetë i sigurt vetëm për atë!

[Shih ed-Deule el-Uthmanijjah: Deule Islamijjah ...", 1/64 Dhe ai filloi sundimin e tij duke e vrarë vëllaun e vet foshnjor, Ahmedin! (Tariikh ed-Deule el-Alijjah, faqe 161).]

Sulltan Sulejman el-Kanuni (dmth legjislatori) (vdiq 974H):

Ai është gjithashtu një nga sulltanët më të famshëm të shtetit Uthman, dhe sundimi i tij ishte rreth 46 vjet.

Kur ai hyri në Bagdad, ndërtoi një kupolë mbi varrin e Ebu Hanifes. Dhe ai i vizitoi vendet e shenjta të Rafidive në Nexhaf dhe Qerbela, dhe rindërtoi aty strukturat që kishin filluar të përkeqësoheshin.

[Shih ed-Deule el-Uthmanijjah: Deule Islamijjah..., 1/25 dhe Tariikh ed-Deule el-Alijjah, faqe 223.]

Dhe ai u quajt "El-Kanuni", sepse ishte i pari për ti paraqitur ligjet evropiane mbi Muslimanët dhe për t'i bërë ato të zbatuara në gjykata. Dhe ishin çifutët dhe krishterët që e ndikuan atë për ta bërë këtë.

[Shih Veeki'unaa el-Mu'aasir, faqe 160 dhe Tariikh ed-Deule el-Alijjah, faqe 177 dhe faqe 198 dhe më tutje]

Sulltan Salim Khaan i Treti (vdiq 1223H]

Imam Sa'ud Ibn Abdul-Aziz - Rahimehllahu Te'ala ka thënë në letrën e tij drejtuar guvernatorit të Bagdadit, të cilin e kemi përmendur më parë:

"Situata juaj, dhe gjendja e imamëve dhe sultanëve tuaj, dëshmon mbi të kotën dhe mbi gënjeshtrën tuaj në lidhje me atë (dmth. Pretendimin e tyre ndaj Islamit).

Sepse ne e kemi parë, kur e hapëm el-Huxhrah esh-Sherifah (dhomën e Profetit), mbi pronarin e saj (ﷺ) qofshin lutjet dhe selamet më të mira. Në vitin 22, një letër nga sulltani i juaj, Selimi, ishte dërguar nga kushëriri i tij tek i Dërguari i Allahut ﷺ , duke kërkuar ndihmë prej tij dhe duke i bërë thirrje atij që të u japë fitore mbi armiqtë.

Dhe ajo përmban përulësi të mjaftueshme, nënqmim dhe vetë-poshtërim për ta dëshmuar të kotën tuaj.. Fillon: "Nga robi i ytë, Sulltan Selimi. Në vazhdim: O ResulAllah, kemi përjetuar vështirësi dhe vuajtje që nuk jemi në gjendje të shmangëm, dhe skllevërit e kryqit kanë marrë përsipër robërit e er-Rrahmanit! Në të lutem ty që të na dhuron fitore mbi ta dhe të na ndihmon kundër tyre ". Dhe ai përmendi shumë fjalë të këtij kuptimi të përgjithshëm. Pra shikoni këtë shirk të tmerrrshëm, dhe kufr në Allahun, Një, Të Gjithëdijëshëm!

Madje mushrikët nuk e kërkuan këtë nga idhujt e tyre el-'Uzzaa dhe el-Laat, sepse kur vështirësit dhe fatkeqësit zbritnin mbi ta ata thërrisnin vetëm Krijuesin e të gjithë krijesave! "[Mbaron citati].

[Shih ed-Durar es-Senijjah, faqe 160 dhe Tariikh ed-Deule el-Alijjah, faqe 177 dhe faqe 190 dhe më tutje]

Sulltan Abdul Hamiid i Dyti (vdiq 1327H):

Ky sulltan ishte një fanatik Sufi mbi tarikun Sheedhili. Këtu është një letër prej tij tek shejhu i tarikatit Sheedhili i kohës së tij.

Ai thotë në të:

"I gjithë lavdërimi i takon Allahut ... Unë e ngrej këtë kërkesën time tek shejhu i lartë i tarikatit Sheedhili dhe atij që zbrazë shpirtin dhe jetën, shejhun e njerëzve të moshës së tij, Shejh Mahmuud Efendiu, Abush-Sheemaat, dhe unë i puthi dy duart e tij të bekuara, duke shpresuar për lutjet e tij të drejta. Zotëruesi im:

Nga tevfiku (suksesi) i Allahut unë vazhdimisht jam duke e recituar evraadin e Sheedhili'jatit natë e ditë dhe kërkoj që të vazhdoj për të qenë në nevojë të përhershme për lutjet tuaja të përzemërta ".

[Shih Imam et-Teuhid nga Ahmed el-Kattan dhe Muhammed Zejn, faqe 148 dhe et-Tariik ilal-Xhemaa'ah el-Umm, faqe 56 dhe dhe revistën e ndyrë të Kuvajtit el-'Arabi, numër 157-169.]

Dhe tarikati Sheedhili është sufi, adhurues të varreve, e bazuar në shirk, e mbushur me ndyrësi të mjaftueshme dhe blasfemi (sharje të Zotit) për ta klasifikuar atë në mesin e kuffarëve që i adhurojnë idhujt.

[Shih disa nga format e shirkut, devijimit dhe bidatëve të tyre në Diraasaat fit-Tasavvuf, faqe 235, dhe et-Tasavvuf Miizaan el-Bahth vet-Tahkiik, faqe 327.]

Sa për historitë dhe marrëdhënieve e këtij shteti me çifutët dhe krishterët dhe kuffarët tjerë, në emërimin e tyre në pozita të pushtetit, ndihmës ndaj tyre dhe madje duke i bërë ata të barabartë me Muslimanët, atëherë janë të shumta. Shikoni, nëse dëshironi, në Tariikh ed-Deule el-'Alijjah dhe ed-Deule el-Uthmaanijjah: Deule Islaamijjah ... dhe vështirë që do të gjeni një sulltan Uthman të vetëm, jeta e të cilit nuk paraqet diçka prej kësaj.

Shih, për shembull, jetën e 'Abdul Mexhid ibn Mahmud'it, i cili e lëshoi Dekretin Gulkhanah në vitin 1255H, në të cilin ai shpalli liri të plotë tek çështjet personale dhe tek ide'et dhe i bëri jomuslimanët të barabartë me Muslimanët.

Shih Tariikh ed-Deule el-Alijjah, faqe 455, dhe el-Islam vel-Hedhaarah el-Gharbijjeh, faqe 15.]

Sektori:

Sa i përket luftës së Uthmanlive kundër Teuhidit, atëherë ajo është e mirënjohur. Sepse ata shpallën luftë kundër davetit të Shejh Muhamed ibn AbdulVahabit Rahimullah - siç dihet. "Ata dëshirojnë ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre". Dhe ata dërguan fushatë pas fushatës për luftë kundër pasuesve të Teuhidit, derisa ata e kurorëzuan këtë luftë të tyre me shkatërrimin e ed-Dir'ijjah'ës, kryeqytetin e ed-Daves es-selefijah, në vitin 1233H.

[Të njohësh rreth disa nga krimet e tyre, shih 'Unvaan el-Mexhd, 1/157.]

Dhe Uthmanlitë, në luftën e tyre kundër Teuhidit, kërkuan ndihmë nga vëllezërit e tyre Krishterë. Përshkak se një nga studiuesit në Evropë zbuloi dokumente të korrespondencës midis Napoleon Bonapartit, sundimtarit të Francës dhe "el-Baab el-Aali" ("*Dera e Lartë", titulli i "sundimtarit Uthman*") lidhur me davetin e Shejh Muhammed ibn AbdulVahabit dhe domosdoshmëria e marrjes së veprimeve vendimtare kundër tij, pasi ajo ishte një kërcënim për interesat e tyre në lindje.

[Parathënia e 'Atijjeh Selim tek libri el-Imam Muhammed ibn' AbdulVahab, nga Ibn Baaz. Dhe studiuesi ishte Ahmed et-Taviil, përderisa prezantoi doktoraturën e tij.

Dhe gjatë luftrave të 'Uthmanlive kundër pasuesve të Teuhidit, u kryen mizori të tilla që i bërën ato të kryqëzatave të zbehta në krahasim. Këtu janë disa shembuj për ju:

Shteti Uthman dëshironte ti nxiste ushtarët e vet për ti vrarë njerëzit e Teuhidit, prandaj lëshuan një dekret që çdo ushtar do të merr një shpërblim për secilin që ai e ka vrarë dhe ishte e nevojshme që ushtari ta vërtetoj vrasjen e tij duke i prerë veshët e viktimës së tij dhe për ti dërguar ato në kryeqytetin Astaanah (Stambollë). Kështu ata e bërën këtë në Medine, el-Kunfudhah, el-Kasiimm, Dhirmaa dhe vende tjera.

[Shih këtë në detaje në Tarikh el-'Arabijjah es-Sa'udijjah, nga historiani rus Vasiliev, faqe 173, 183, 176 dhe 184.]

Sa për shkatërrimin e tyre të fshatrave dhe qyteteve dhe madje edhe djegien e tyre të Mezxhidëve, atëherë tregoni pa vështirësi.

[Shihni këtë në 'Unvan el-Mexhd, 1 / 157-219, dhe gjithashtu në referencën e mëparshme.]

Dhe nga krimet e tyre është se ata morën i gratë dhe fëmijët e pasuesve të Teuhidit si robër dhe i shitën si skllevër. El-Xhebarti tha në Tarikh'ën e tij:

"Dhe muaji i Seferit filloi në një të Premte në vitin 1235H ... dhe gjatë këtij (muaji) erdhi një grup i ushtrisë Arabe dhe Maghribe, të cilët kishin qenë në vendin e Hixhazit dhe ata ishin shoqëruar nga të burgosurit " Vahabitë ", gratë, vajzat dhe djemtë. Ata erdhën në Hamajil dhe i shisnin ato për këdo që i blinte, edhe pse ata ishin Muslimanë dhe njerëz të lirë". [Mbaron citati.]

[Tarikh 'Axhaa'ib el-Aatheer, 3/606. Por kini kujdes në lidhje me këtë libër, sepse el-Xhabarti, siç është e dukshme nga Tarikati i tij, ishte një sufi khalvati i cili i nderoi varrezat dhe evlijat, madje edhe të devijuarit heretikë siç është zindiki Ibn Arabi.]

Dhe përfundoj këtë me këtë ngjarje që u transmetua nga një historian Rus. Ai tha:

"Në vitin 1818 - dmth. 1234H - 'Abdullah (Imam' Abdullah ibn Sa'ud ibn Abdul-Aziz ibn Muhammed ibn Sa'ud, imami i fundit i shtetit të parë Sa'uud) është marrë nëpërmjet rrugës el-Kahira (Kajro) për tek Astaanah (Stamboll), të shoqëruar nga dy prej atyre që ishin të afërtit e tij, në fillimim e Kanun el-Evel (Dhjetor) dhe ambasadori Rus në Astaanah dha informatat e mëposhtme:

"Javën e kaluar, kreu i Vahabijunëve (Vahabistëve), ministri i tij dhe imami i tij, të cilët ishin kapur në ed-Dirijjah dhe më pas ishin dërguar në kryeqytet, u prenë kokat e tyre. Duke kërkuar të shtojë përshtypjen e fitores së tij ndaj armiqve më të këqij të dy qyteteve që konsiderohen të jenë djepi (burimi) i Islamit, sulltani urdhëroj atë ditë që një asamble të bëhej në pallatin e vjetër në kryeqytet dhe ata i sollën tek pallati tre të burgosurit, të lidhur në zinxhirë të rëndë dhe të rrethuar nga turma e spektatorëve. Dhe pas formaliteteve hyrëse, sulltani urdhëroi ekzekutimin e tyre, kështu që kreut iu pre koka përpara portës kryesore të "Aja Sofjes" , dhe ministrit iu pre koka para hyrjes "Saraaj", dhe të tretit iu pre koka në një nga tregjet kryesore në kryeqytet. Dhe trupat e tyre u ekspozuan me kokat e tyre nën sqetulla (ndërsjetlla) dhe pas tri ditësh u hodhën në det. Dhe 'madhëria' e tij urdhëroi respektimin e një lutje të veçantë falënderimi ndaj Allahut për fitoren e ushtrive të Sulltanit dhe për shfarosjen e grupit që kishin hedhur mbeturina në Mekë dhe Medine, përhapnin frikë në zemrat e Muslimanëve dhe i ekspozonin ata në rrezik. "[Mbaron citati.]

[Tariikh ed-Deule es-Sa'udijjah, nga Vasilev, faqe 186.]

Sektori:

Pra, kjo ishte armiqësia e tyre ndaj Teuhidit dhe njerëzve të saj, dhe kjo ishte përhapja e tyre e shirkut dhe kufrit. Pra, si mund të pohohet se ky shtet i korruptuar, i pafe ishte një "hilafet islamik" ?! Allahu e mëshiroftë Imam Sa'ud ibn Abdul-Aziz (vdiq 1229H) kur guvernatori Uthman të Irakut i tha atij:

"Sepse ne jemi muslimanë në të vërtetën dhe kjo është ajo që të gjithë imamët tanë kanë rënë dakord, nga të katër medh'hebët, dhe muxhtehidët e Dinit dhe Mil'as "

Kështu që Imami iu përgjigjë:

"Ne kemi sqaruar nga Fjalët e Allahut Te'ala, fjalët e të Dërguarit të Tij dhe fjalët e pasuesve të katër Imamëve, atë që hedh poshtë rastin tuaj të dobët dhe e mposht pretendimin tuaj të rremë. Sepse jo gjithkush që bën një kërkesë e vërteton atë me veprimin e tij. Dhe një person i varfër nuk bëhet i pasur thjesht duke thënë: "Një mijë dinar!" Dhe një gjuhë nuk digjet thjesht duke thënë: "Zjarr". Sepse me të vërtetë, çifutët, armiqtë e të Dërguarit të Allahut (ﷺ) i thanë të Dërguarit të Allahut kur ai i thirrëste ata në Islam: "Ne jemi Muslimanë!" Edhe krishterët thanë të ngjashme me këtë. Po ashtu, Faraoni i tha popullit të tij: "Dhe unë nuk ju tregoj përveç asaj që unë shoh të jetë e saktë dhe unë nuk ju udhëzoj përveç rrugës së korrektësisë (drejtë)". Megjithatë ai gënjeu dhe shqiptoi gënjeshtra (të kota) në këtë. "[Mbaron citati.]

[ed-Durar es-Senijjah, 1/391.]

Po ashtu, kushdo që pohon se shteti i Uthman ishte një shtet Musliman, atëherë ai ka shqiptuar një gënjeshtër dhe një të kotë, dhe falsifikimi më i madh lidhur me ketë drejtim është se ajo ishte një Hilafet Islam!

[Fakti që shteti i Uthman ishte një shtet kufri nuk e bënë të nevojshëm tekfirin e të gjithëve mbrenda saj dhe dy djemtë e Shejh Muhamed ibn 'AbdulVahabit (Husejni dhe' Abdullahi) - Rahimehumullahu Te'ala -

"Mund të thuhet se ky fshat është mbi kufr dhe populli i saj kufar, gjykimi i të cilëve është i njejt si i kuffarëve, por nuk gjykohet që çdo individ i tyre se është vetë kafir, sepse është e mundur që në mesin e tyre janë ata që janë mbi Islam, të cilëve u është justifikuar bërja e hixhretit, apo që haptazi e ka shfaqur fenë e tij, megjithatë Muslimanët nuk e dinin për të ".

[Mexmuu'et el-Masaa'il, 1/44.]

Dhe dije, o vëllai im, se askush nuk pretendon që shteti Uthman ishte një shtet Islam përveç njërit nga këta dy persona :

Ose një devijant i humbur që e sheh se shirku është Islam.

Ose një person i paditur rreth çështjes së këtij shteti.

Sa i përket atij që e kupton Teuhidin dhe e kupton se çfarë ka qenë ky shtet dhe ende ka dyshime në lidhje me çështjen e saj, atëherë ai është në një pozitë shumë të rrezikshme, Vallaahul-muste'aan (dhe nga Allahu kërkojm ndihmë).

Sa i përket atij që e kupton Teuhidin dhe e kupton se çfarë ka qenë ky shtet dhe ende ka dyshime në lidhje me çështjen e saj, atëherë ai është në një pozitë shumë të rrezikshme, Vallaahul-muste'aan (dhe nga Allahu kërkojm ndihmë).

Sektori i dytë:

Pikpamja e Davetit të Shejh Muhammed ibn AbdulVahab lidhur me atë.

Një prej keqkuptimeve që shpesh sjellën në lidhje me Davetin e Shejh Muhamed ibn 'AbdulVahabit - Rahimehullahu Te'ala - është se ky (davet) u ngrit kundër Hilafetit Uthman dhe i përçau Muslimanët.

Dhe shumë prej ulemave që e mbronin Davetin e Shejhut u përpoqën t'u përgjigjen këtij koncepti të gabuar, por më së shumti që ata mund të thoshin ishte:

"Nexhdi, që nga fillimi, ishte i pavarur nga shteti Uthman, kështu që për këtë arsyje ardhja e Shejhut nuk ishte një kryengritje kundër asaj "

[Shih Da'vaa el-Munaavi'iin, 233-240.]

Dhe realiteti është se kjo deklaratë është e pasaktë, për tre shkaqe:

E para është se shteti Uthman kishte sundimin nominal mbi Nexhdin, sepse ajo e sundonte Hixhazin. Jemenin, Irakun, dhe Shamin dhe taksat e emirave të Nexhdit zakonisht vinin tek shteti (Uthman) nëpërmjet disa nga këto vende.

[Shih ed-Deule el-'Uthmaanijjah ... 1/20, dhe 'Unvaan el-Mexhd, 1/97 dhe më tutje.]

E dyta është se edhe sikur të supozojmë se Nexhdi ishte i pavarur, Daveti i Shejhut kishte hyrë në Hixhaz, Jemen, Ahsaa, Khalixh, dhe në zonat e largëta të Irakut dhe Shamit. Ata e sulmuan Qerbelan dhe e rrethekuan Damaskun, dhe të gjitha këto ishin padyshim nën kontrollin e shtetit Uthman.

E treta është se fjalët e imamëve të Davetit - Rahimehumullaah - janë në pajtim që shteti Uthman ishte Daar el- Harb (shtet në një gjendje lufte me Muslimanët), përveç atyre që iu përgjigjën Davetit të Teuhidit , siç do ta shohim më vonë, In shaa 'Allahu Te'ala.

Përshkak se Daveti i Shejhut -Rahimehullah - ishte Davet tek Teuhidi i pastër, dhe luftë kundër shirkut dhe pasuesve të saj dhe një nga mbrojtësit më të mëdhenj të shirkut të asaj kohe ishte shteti Uthman.

Kështu që Daveti ishte një akt lufte kundër tyre dhe unë do të tregoj, në vijim, thënje të ndryshme nga imamët e Davës dhe pasuesit e tyre, duke sqaruar qëndrimin e tyre lidhur me këtë shtet:

Imam Sa'ud Ibn Abdul-Aziz - Rahimehullah (vdiq 1229H):

Unë kam transmetuar tashmë disa thënje nga ai lidhur me çështjen e këtij shteti.

Këtu kemi më shumë nga deklaratat e tij në letrën që ai ia dërgoi guvernatorit të Bagdadit:

"Dhe sa i përket thënies tuaj:

"Si mund të nxitni fitne me guxim dhe pa mend duke shkaktuar fitne me bërjën e tekfirit ndaj Muslimanëve dhe njerëzve të kiblës dhe të luftoni kundër një populli që e beson Allahun dhe Ditën e Fundit ...? "

Pra, ne themi:

"Ne kemi deklaruar tashmë që ne nuk bëjmë tekfir për shkak të mëkateve, por më tepër ne luftojmë vetëm kundër atyre që bëjnë shirk ndaj Allahut dhe i atribojn ortak Allahut, duke i thirrur ata sikurse e thërrasin Allahun, duke therur për ta sikurse therrin për Atë, duke iu betuar atyre sikurse i betohen Allahut, duke iu frikësuar atyre sikurse i frikësohen Allahut, duke i thirrur ata për ndihmë në vështirësi dhe për sjelljën e të mirave dhe të cilët luftojnë për ti mbrojtur idhujt dhe kupat e ndërtuara mbi varre, të cilat janë marrë si idhuj të adhuruara përveç Allahut. Pra, nëse jeni të sinqertë në pretendimin tuaj se jeni në Milah'n e Ibrahimit dhe pas të Dërguarit ﷺ, atëherë shkatërroni këto idhuj, të gjithë ato dhe rrafshoni ato në tokë. Dhe pendohuni tek Allahu nga i gjithë shirku dhe bid'ati. "

Pastaj ai tha: "Ose, nëse vazhdoni të qëndroni mbi këtë gjendjen e juaj dhe nuk pendoheni nga shirku që jeni në të dhe ta zbatoni drejt fenë e Allahut me të cilën Ai e dërgoi të Dërguarin e Tij, duke e lënë shirkun, bidatin dhe paragjykimet , atëherë ne nuk do të pushojmë së luftuari derisa të ktheheni në fenë e drejtë të Allahut. "

[Ed-Durar es-Senijjeh, 7/397]

Shejh Sulejman ibn Abdil-lah ibn esh-Shejh - Rahimehullah - (vdiq 1233H):

Kur Turqit e pushtuan tokën e Teuhidit, Shejh Sulejman ibn 'Abdilaah shkroi një libër të titullar -***ed-Delaa'il*** -(argumentet) lidhur me riddën (felëshimin) dhe kufrin e çdonjërit që i ndihmoi atyre dhe iu bashkua atyre, edhe nëse ai nuk ka qenë në fenë e tyre të shirkut. Dhe ai përmendi aty më shumë se njëzet argumente mbi këtë, dhe ai iu referiohej ushtrisë pushtuese si "trupat e kupave (të varreve) dhe të shirkut".

[Ed-Durar es-Senijjeh, 7/57-69]

Shejh Abdul-Latif ibn AbduRrahman ibn Hasan - Rahimehullah (vdiq 1293H):

Në një nga letrat e tij drejtuar Shejh Hamed ibn 'Atiik - rahimehullah - në lidhje me rastin e' Abdullah ibn Fejsalit, imamit në atë kohë, duke kërkuar ndihmë nga 'Uthmanlitë kundër vëllait të tij Sa'ud ibn Fejsal, kur ky i fundit e mposhti atë në betejën e Xhudës gjatë ngjarjeve rreth vitit 1289H, ai tha:

"Dhe Abdullahu kishte një sundim të ligjshëm dhe bejjah (besatim) në përgjithësi, por më vonë kuptova se ai kishte bashkpunuar me shtetin kafir (dmth Shtetin Uthman), kërkoi ndihmë prej saj dhe e solli atë tek tokat e Muslimanëve. Kështu ai u bë sikur ai për të cilin thuhet [poezi]:

"Dhe ai që kërkon mbrojtje me 'Amr në vështirësitë e tij, është si ai që kërkon mbrojtje me zjarr nga nxehtësia e zjarrtë.."

Kështu që i fola atij gojarisht, duke kundërshtuar veprimin e tij dhe duke i deklaruar mosmarrëveshjet e mia nga ajo, dhe i flisja ashpër atij, duke i thënë se kjo është shkatërrim i themelëve të Islamit dhe çrrënjosje e bazave të saj dhe se kjo ishte kjo dhe ajo dhe tjetra ... Detajet e të cilës bisedë nuk i mbaj mend tani, kështu që ai shprehu pendimi dhe keqardhje, dhe bëri shumë istighfar. Dhe unë shkruva, tek udheqësi i tij, tek guvernatori i Bagdadit:

"Allahu na ka mjaftuar, e ka bërë të lehtë dhe i ka rregulluar popullatën e Nexhdit dhe Beduinët gjë që e ka përmbushur nevojën tonë Insha'Allah. Kështu që ne nuk kemi nevoj për ushtrin e shtetit ", dhe fjalët për atë ndikim. Dhe unë besoj që ai e dërgoi letrën dhe u asgjësua nga ajo që kishte ndodhur, dhe kjo ishte një letër e gjatë. "[Mbaron citati.]

[Ed-Durar es-Senijjeh, 7/184, dhe Tedhkirat Ulin-Nuhaa vell-'Irfaan, ngjarjet e vitit 1289H, nga vëllimi i parë.]

Dhe ai tha në një letër tjetër tek njëri nga kërkuesit e dijes lidhur me të njëjtën çështje:

"Sa i përket Imam Abdullah ibn Fejsalit, atëherë unë e kam këshilluar atë, siç e kam përmendur, me këshilla shumë të ashpra. Dhe unë ia kujtoja atij këshillën e Ajetëve të Allahut dhe të drejtës së Tij dhe detyrimin e të preferuarit së kënaqësisë së Tij , duke qëndruar larg nga armiqët e fesë së Tij, njerëzit e te'tiil-it (mohimit të Sheriatit), shirkut dhe kufrit të qartë, dhe ai shprehu pendim dhe keqardhje ... "[Mbaron citati].

[Mexhmu'at er-Rasaa'il, 2/69]

Dhe ai tha në lidhje me hyrjen e Uthmanlive në Gadishullin (Arabik) në vitin 1298H:

"Pra, kushdo që e kupton këtë parim themelor - dmth Teuhidin - do të kuptojë dëmin e fitnes që është e tanishme në këto kohëra në lidhje me ushtritë Turke dhe ai do ta kuptojë se ajo (dmth. Fitneja) kthehet në këtë parim, duke e thyer atë (Teuhidin), duke e shkatërruar dhe duke e çrrënjosur atë plotësisht dhe ajo shpie tek mbizotërimi i shirkut dhe te'tiilit dhe ngritjen e flamujve të kufrit ".

[Ed-Durar es-Senijjeh, 7/148-152]

Dhe ai tha në një poemë rreth kësaj çështjes:

Dhe kreu i popullit ka sjellur tek Turqit një shtet i cili ka kryer krimet më të mëdha kundër Milah'ës të Islamit.

Dhe ajo përmban:

Dhe ata udhëtuan tek populli i shirkut dhe iu nënshtruan atyre,

Dhe u erdhi atyre çdo shpifës dhe çdo magjistar.

Dhe ajo përmban:

Dhe fuqia ka shkuar tek njerëzit e refuzimit dhe shirkut, dhe nga ata është krijuar tregu i shkatërrimit dhe i së keqes. Dhe vendet e amoralitetit dhe poshtërsis janë kthyer në mesin e tyre, të cilat frekuentohen nga çdo njeri amoral. Dhe uniteti i fesë është shkatërruar dhe litarët e saj janë prerë, dhe ajo është bërë e humbur në radhët e ushtarëve.

Dhe ajo përmban:

Dhe ju keni bërë aleancë me njerëzit e zjarrit, në marrëzin tuaj, dhe ju jeni bërë, për fenë e Allahut, kuffarët e parë. Pra, kërkoni banuesin e Ahsaa's, a jeni besimtarë në këtë, dhe tek ajo çka përmbahet në librat autentike?

[Ed-Durar es-Senijjeh, 7/187-191, dhe Tedhkirat Ulin Nuhaa.. 1/198-202]

Dhe ai e përmendi këtu posaçërisht el-Ahsaa'n sepse Uthmanlitë, pasi që Imami 'Abdullah u kishte kërkuar ndihmë, hyrën në Ah-saa dhe e morën atë së pari.

Shih detajet e kësaj në ngjarjet e vitit 1289H, nga Tedhkirat Ulin-Nuhaa 1/197, nga thënia e tij: "Përmendja e asaj se çka ka ndodhur dhe është bërë me ardhjen e ushtarëve Uthman dhe trupave Turke".]

Dhe ai tha në një poemë tjetër:

Kur shfaqet ushtria e devijimit, ta shembin tokën e udhëzimit dhe ligjët e mirësisë, Një popull i dehur, shoku i tyre nuk zgjohej, Asnjëherë, dhe ai do të përfundojë në humbje, Një popull, ju i shihni ata nxitojnë në çdo mbledhje në të cilën është fatkeqësia dhe çdo kufr është nga afër, Në të vërtetë, në të cilën ligjet e krishterëve janë duke sunduar, Pa asnjë tekst që ka ardhur nga Kur'ani. Pra, shikoni tek lumenjtë e kufrit që kanë shpërthyer, Ata janë përleshur me Sheriatin e er-Rrahmanit.

[Ed-Durar 192-194, et-Tedhkirat 1/203-206]

Dhe gjëja mahnitëse është se ky është përshkrimi i ushtrisë Uthmane në vitin 1289H, dhe në Tariikh të Xhabarit ka një përshkrim identik të trupave që hynë në Gadishull rreth vitit 1226H, siç thotë ai në Tariikh (3/341):

"Dhe disa nga njerëzit e tyre të lartë që thërrasin drejtësinë dhe devotshmërinë më thanë:

"Si do të arrijmë fitore kur shumica e ushtarëve tanë nuk janë në Mil-lah (fe), dhe në mesin e tyre janë ata që nuk e praktikojnë fenë? Dhe sollën me vete sënduk me pije dehëse dhe nuk dëgjonit më kurrë në radhët tona thirrje të Ezanit, as nuk u kryente më namazi i detyrueshëm në mesin e tyre, dhe ata nuk i dhuruan më asnjë shqetësim simboleve të fesë ... etj. "[Mbaron citati.]

Shejh Hamed ibn Atiik - Rahimullah Te'ala (vdiq 1301H):

Ai ishte - rahimehullaahu Te'ala - njëri nga Ulemat më të rreptë në qëndrimin e tij në lidhje me këtë shtet. Shihni letrat e shkruara mes tij dhe Shejh Abdul-Latiif bin AbduRrahman ibn Hasanit në vëllimin e shtatë dhe tetë të - ***ed-Durar es-Seniyjjeh-*** dhe unë i kam përmendur disa prej tyre. Dhe kur ushtrita e kufrit Uthamane hyrën në Gadishullin Arabik, disa nga tradhtarët dhe devijantët nga beduinët hyrën në radhët e tyre. Kështu që, ashtu si Shejh Sulejman ibn 'Abdil-lah - Rahimehullaahu Te'ala - që kishte shkruar librin -***ed-Dala'il***- (argumentet), kur' Uthmanlitë hyrën në Gadishull në kohën e tij, lidhur me gjykimin rreth ndihmës ndaj tyre, po ashtu Shejh Hamed - Rahimehullaahu Ta'ala - shkroi një libër me titull - ***Sebiil en-Nexhah vel-Fikaak min Muveelaat el-Murtadiin vel-Atraak*** - (Rruga e Shpëtimit dhe Lëshimit nga miqësimi me Felëshuesit dhe Turqit), lidhur me tekfirin e kujtdo që i ndihmoi këto ushtri që u quajtën " Islamike "!!

[Ky libër është shumë i njoftur me emrin - ***Sebiil en-Nexhah vel-Fikaak min Muveelaat el-Murtadiin va-Ehl el-Ishraak*** - (Rruga e Shpëtimit dhe Lëshimit nga miqësimi me Felëshuesit dhe pasuesve të shirkut) në vend të (asaj më nalt) -***vel-Atraak***- (dhe Turqit), dhe emri i saktë është ai që kemi përmendur për këto arsye:

a] Kopja origjinale e shkrimit ishte i këtij titulli, dhe ishte nga koha e Shejhut. Shih Sebil el-Nexhah me redaktimin e el-Farjaan'it, faqe 12.

b] Shejhu vetë e përmendi këtë titull në hutbën hyrëse të librit të tij Sebiil en-Nexhah, faqe 24.

c] Koha e shkrimit të librit dhe përmbajtja e saj tregojnë për këtë titull, siç është thënia e tij në faqen 35: "O ju që keni besuar, mos i merrni çifutët dhe krishterët si evlija (për miqë) ..." Dhe po ashtu, kushdo që miqësohet me Turqit bëhen një Turk. "Dhe Allahu e di më mirë.

Shejh Abdullah ibn Abdul-Latiif - Rahimullahu Te'ala (vdiq 1339H]:

Ai ishte pyetur - Rahimehullaahu Te'ala - rreth atij i cili që nuk bënte tekfir mbi shtetin (dmth Shtetin Uthman) - dhe ndaj atij që i solli ata për të luftuar kundër Muslimanëve dhe e zgjodhi vilajetin e tyre (autoritetin) dhe se ishte e detyrueshme për të zhvilluar xhihad pranë tyre (Uthmanlive), dhe rreth atij që nuk e kishte këtë qëndrim por më tepër i cili tha: Se shteti dhe ata që i sollën ata ishin Muslimanë rebelues (bughaat), dhe nuk është e ligjshme të merrem me ta veçse në mënyrën e trajtimit të rebeluesit/shkelësit Musliman dhe se ajo që u morë si plaçkë nga beduinët është haram.

Kështu që ai u përgjigj:

"Çdo kush që nuk e njeh kufrin e shtetit dhe nuk bën dallim mes tyre dhe bughatëve (rebeluesve) Muslimanë, atëherë ai nuk e di kuptimin e" La ilahe-ila- Llah ".

Po, nëse ai beson së bashku me atë se shteti është Musliman , atëherë kjo është edhe më e keqe dhe më e rëndë, sepse është të dyshuarit e kufrit të atij që ka bërë kufër në Allahun dhe shirkut me Të. Kushdo që ika sjellur ata dhe i ndihmoi atyre kundër Muslimanëve me çdo llojë të ndihmeses, atëherë kjo është felëshim (Ridde) e qartë" [Fundi i citatit.]

[Ed-Durar es-Senijjeh, 8/242]

Shejh Sulejman ibn Sehman- Rahimehullahu Te'ala (vdiq 1349H):

Ai tha - Rahimehullah - në një poemë të tij:

Dhe çfarë thuhet rreth përshkrimit të Turqve lidhur me kufrin e tyre, atëherë është e vërtetë, sepse ata janë më mosbesuesit e njerëzve (akfar en-naas) në fe.

Dhe armiqësia e tyre ndaj Muslimanëve dhe e keqja e tyre, rritet dhe zmadhohet në devijim, më shumë se sektet tjera. Dhe kushdo që e merr kafirin si evlija atëherë ai është si ata, dhe nuk ka dyshim në lidhje me tekfirin e tij për çdo kënd që posedon intelekt . Dhe çdo kush që bashkohet me ta ose shkonë drejt tyre me mbështetje, atëherë nuk ka dyshim e të shpalluarit ndaj tij si një faasik dhe ai është në një pozitë të lëkundshme.

[Diivann ibn Sahmaan, faqe 191.]

Shejh Abdullah ibn Muhammed ibn Selim - Rahimehullah - (vdiq 1351H):

Shejhu - Rahimehullah - ishte ulur pasdite në cepin e Mesxhidit të el Xha'mit ', duke pritur për namazin e Akshamit dhe në radhët (safët) e para kishte njerëz që nuk e dinin se shejhu ishte i pranishëm aty. Kështu njëri prej tyre i foli shokut të tij duke i thënë atij:

"Ka arritur tek ne se shteti Uthman ka dominuar dhe se flamujt e tyre janë bërë fitimtare!" Dhe vazhdoi ti lavdëronte. Kështu që, pasi që Shejhu u fal me ta, dhe pas namazit ai dha një ligjërat prekëse dhe vazhdoi duke i fajësuar 'Uthmanlitë dhe duke i fajësuar ata që i donin dhe i lavdëronin [duke thënë]:

"Çdo kush që e tha këtë thënie, duhet ti bie pishman për atë që e tha dhe të pendohet për të! Çfarë feje është aty për atë që i do kuffarët dhe është i lumtur me epërsin (dominimin) e tyre dhe përparimin e tyre?! Nëse Muslimani nuk e rrethon vetën e tij me Muslimanët, atëherë me kë do të bashkohet ai? "

[Tedhkirat Ulin-Nuhaa, 3/275.]

Shejh Husejn ibn Ali ibn Nufejsah [një nga bashkëkohësit e Shejh Sulejman ibn Sehmanit] tha në një nga poemët e tij:

Pra, O shteti i Turqve, kurr mos u ktheft fuqia e juaj prap tek ne dhe tek vendlindjet tona, kurr mos u kthefshi. Ju e morrët fuqinë dhe e kundërshtuat rrugën e Profetit tonë, dhe të këqijat dhe dehjet ju i bëtë të lejuara. Ju i bëtë simbolet e mushrikëve simbolet e juaja. Kështu që ju u bëtë më të shpejtë në kryerjen e shirkut se ata që ishin. Ju i dhurat besimit të krishterëve para-lartësi, kështu që ju keni marrë papastërti mbi papastërti të madhe. Pra, larg me ju, zhdukuni ju, mposhtja mbi ju, dhe kushdo që ju ka dashur dhe është i prirur ndaj jush.

[Tedhkirat Ulin- Nuhaa, 2/149]

Dhe në një poemë të Salih Ibn Selimit, në kujtimin e Ibn Sehmanit: Dhe ai i sqaroi aty vendimin e Turqve, kufrin e tyre dhe gjykimin e miqësisë dhe aleancës me shtetin.

[Tedhkirat Ulin-Nuhaa, 3/254.]

Dhe 'AbduRrahman ibn' Abdul-Latiif ibn 'Abdil-lah ibn Abdul-Latiif Aal es-Shejh ka thënë:

"Dhe është e njohur se shteti Turk ishte një shtet adhurues i idhujve, feja e të cilës ishte shirku dhe bidati, dhe të cilët kishin zakon për ti mbrojtur gjëra e tilla ..." [Fundi i citatit.]

['Ulemaa' ed-Da'vah, shkruar nga ai, faqe 56.]

Sektori:

Është e qartë nga ajo që ka paraprirë nga imamët e Da'vës (thirrjës) që e shihnin kufrin e shtetit Uthman", dhe se ky (shtet) ishte Daar el-Harb. Dhe kjo është një çështje e hapur dhe e qartë - Dua të them kufri i shtetit Uthman - dhe unë nuk besoj që dikush që ka lexuar ose dëgjuar rreth saj që ata ishin mbi shirk, ose që ka lexuar se çfarë imamët e Da'vës kan thënë rreth pikëpamjes së tyre nga ky shtet, se do të vazhdojë të mbajë ndonjë dyshim në lidhje me ta..

Përndryshe, njëra nga këto tre të mëposhtmet zbatohen tek ai.

Ose:

a] Ai i akuzon imamët e Da'vesë nga injoranca.

b] Apo e konsideron Teuhidin si një çështje dytësore.

c] Ose është një refuzues kokëfortë.

E lusmi Allahun të na japë sinqeritet dhe pajtueshmëri në njohuritë dhe veprat tona dhe Allahu bekoftë dhe i dhuroftë paqe Profetit tonë Muhammedit ﷺ, familjes së tij dhe të gjithë shokëve të tij.

"Përule veten, ju do të jeni si një yll i ndritshëm për shikuesit në sipërfaqen e ujit edhe në qoftë se ajo është në lartësi."

Shejh Nasr Ibn Hamed El-Fehd - Allahu e liroftë

Përktheu: Argumenti i Qartë